

 KEC Qendra për Arsim e Kosovës Kosova Education Center	SYLLABUSI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT		F-042
	Prishtinë	v. 2.0	Faqe 1 nga 5

Kodi 083

MBROJTJA E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE NËPËRMJET EDUKIMIT, ARTIT DHE MEDIAS

Tipi i Programit: Plotësues

Hyrje

Pakaja SCREAM (Mbrotjtja e të drejtave të fëmijëve nëpërmjet edukimit, artit dhe medias¹) është zhvilluar nga ILO në vitin 2002². Pastaj si material është testuar dhe zbatuar me palë të ndryshme të interesit (mësimdhënës, zyrtarë arsimor, dhe të tjerë), dhe është diskutuar mundësia e aplikimit më gjerësisht në shkolla. Në vitin 2013, pas rekomandimit nga Njësia për të drejtat e njeriut, MASHTI e ka aprovuar për përdorim si material didaktik në shkolla. Një punëtori e mbajtur me 29.05.2013 me DKA, ka diskutuar përmbajtjen, cilësinë e materialit dhe mundësinë e zbatimit në programin shkollor, ku pjesëmarrës ishin 17 zyrtarë të DKA-ve nga komunat kryesore në vendit (Gjakova, Prishtina, Kaçaniku, Ferizaj, Fushë Kosova, Drenasi, Obiliqi, Istogu, Novobërda, Kamenica, Lipjani, Juniku, Rahoveci dhe Suhareka) dhe tre përfaqësues të MASHTI-t. Pastaj, me mbështetje të ILO-së materiali është ri-botuar në gjuhën shqipe dhe është shpërndarë i shtypur dhe në formë të CD në të gjitha shkollat e arsimit parauniversitar.

Aktivitetet e SCREAM mundësojnë zhvillimin e aftësive krijuese, shprehëse e sociale të fëmijëve, mundësojnë njohjen e fëmijëve me botën mediatike, përgatitjen për komunikim me mediat si dhe aftësimin e fëmijëve për ndërmarrjen e nismave në vendosjen e një bashkëpunimi me komunitetin. Ato mund të përshtaten sipas kohës dhe burimeve që kemi në dispozicion, sipas kontekstit gjeografik apo kulturor. Si të tilla, këto aktivitete mund të zhvillohen për trajtimin e temës së punës së fëmijëve, por edhe të çfarëdo teme tjetër që ka të bëjë me mbrojtjen e fëmijëve, në kontekst të programeve formale apo jo-formale të edukimit.

MASHTI ka rekomanduar që pakoja SCREAM në shkolla të përdoret si material plotësues mësimor për:

- zhvillimin e përmbajtjeve të rregullta kurrikulare (në kuadër të fushave kurrikulare si 'Shoqëria dhe mjedisi', 'Jeta dhe puna', 'Gjuhët dhe komunikimi', 'Artet', dhe në fushat tjera që trajtojnë temën 'Ndal punës së fëmijëve');
- parandalimin e përfshirjes së fëmijëve në punë duke i vetëdijësuar vet fëmijët, prindërit e tyre dhe komunitetin për efektet negative të punës së fëmijëve;
- fuqizimin e rolit të fëmijëve dhe të rinjve për promovimin e të drejtave të fëmijëve, përfshirë këtu edhe të drejtën për të qenë të lirë nga eksploatimi ekonomik;

¹ Supporting Children's Rights through Education, the Arts and the Media

² Pakoja origjinale edukative SCREAM është zhvilluar në vitin 2002 në kuadër të Projektit të ILO-së Fushatë globale për ngritjen e vetëdijesimit dhe të kuptuarit e punës së fëmijëve", financuar nga Qeveria Italiane.

 KEC Qendra për Arsim e Kosovës Kosova Education Center	SYLLABUSI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT		F-042
	Prishtinë	v. 2.0	Faqe 2 nga 5

- fuqizimin e rolit të fëmijëve dhe të rinjëve për të sensibilizuar institucionet relevante mbi problemin dhe nevojën për intervenim të shtuar;
- mbështetjen e kthimit në shkollë dhe ri-integritit të fëmijëve që kanë braktisur shkollën për shkak të punës.

Gjithashtu u sqaruan format konkrete përmes të cilave shkollat mund të zbatojnë SCREAM dhe ato janë:

1. në kuadër të mësimi të rregullt të lëndëve të ndryshme dhe në kuadër të fushave kurrikulare të përmendura më lart;
2. përmes aktiviteteve jashtë-kurrikulare (në formë të debateve, shfaqjeve teatrale, ekspozitave me punime si produkt i përdorimit të moduleve të caktuara, aktiviteteve të grupit për të drejtat e fëmijëve, etj.);
3. si lëndë zgjedhore, sidomos në shkollat që veprojnë në lokalitete ku shkalla e rrezikshmërisë së fëmijëve për përfshirje në punë është më e lartë.

Në parim, kur pakoja shfrytëzohet në kuadër të mësimi të rregullt, mësimdhënësit mund të zgjedhin ndonjërin nga aktivitetet që mbajnë modulet si të vetëmjaftueshëm për zhvillimin e një njësie mësimore.

Kur pakoja planifikohet të shfrytëzohet me qëllim të mobilizimit të fëmijëve për të sensibilizuar opinion më të gjerë mbi problemin, atëherë preferohet që të zhvillohet një program aktiviteteve (dyjavore apo mujore) me ç'rast përzgjidhen aktivitete nga modulet e ndryshme.

Qëllimet e programit

Qëllimi i parë i pakos SCREAM është aftësimi i kuadrit mësimor për promovimin e mbrojtjes së fëmijëve nëpërmjet edukimit, artit dhe medias. Specifikisht, ky program është përgatitur për trajnimin e trajnerëve të cilët do të zgjerojnë trajnimin me mësimdhënësit tjerë. Kërkesa për përgatitjen e trajnerëve ka dal nga MASHTI, përkatësisht nga Njësia për të Drejtat e Fëmijëve.

Trajnimi i trajnerëve ka për qëllim aftësimin dhe mbështetjen e trajnerëve potencialë për zbatimin e pakos SCREAM dhe për ngritjen e kapacitetit të mësimdhënësve për zbatimin e kësaj pakaje, përmes 14 moduleve vijuese:

- Informacioni kryesor
- Kollazhi
- Kërkimi dhe informacioni
- Intervista dhe sondazhe
- Figura
- Loja me role
- Konkursi artistik
- Shkrimi krijues

 KEC Qendra për Arsim e Kosovës Kosova Education Center	SYLLABUSI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT		F-042
	Prishtinë	v. 2.0	Faqe 3 nga 5

- Debati
- Mjetet e komunikimit
- Dramatizimi
- Tregu i punës
- Integrimi i komunitetit

Përmbajtja

Temat kryesore që duhet të mbulohen përfshijnë:

- Njohjen e të dhënave kryesore për punën e fëmijëve, çështjeve të punës së tyre në mënyrë të kuptueshme nga të rinjtë, duke dhënë shifra, tregues statistikorë dhe informacion kryesor;
- Nxitjen për të shprehurit artistik vizual dhe pasqyrimin të vëmendjes së pamjaftueshme që shtypi ka për problemin e punës së fëmijëve;
- Kërkimin dhe gjetjen e një informacioni sa më të gjerë për punën e fëmijëve, përfshirë këtu edhe konventat ndërkombëtare, për t'u thelluar në këtë problem;
- Zhvillimin e një interviste apo sondazhi në mjedise që interesohen për punën e fëmijëve, duke paraqitur teknikat e intervistës dhe nxitur veprimtarinë kërkimore për të nxjerrë në dukje se çfarë bëjnë të tjerët për punën e fëmijëve në sektorë të ndryshëm të ekonomisë dhe shoqërisë;
- Krijimin e profilit të një fëmije që punon, përmes figurave të ndryshme, duke nxitur të pranishmit të përfshihen emocionalisht e me ndërgjegje në trajtimin e problemit;
- Futjen në rolin e fëmijës që punon dhe të personave që kanë lidhje me të, duke përdorur dramatizimet me qëllim edukativ;
- Pjesëmarrjen apo organizimin e një konkursi për punën e fëmijëve, duke nxitur shprehjen artistike dhe promovuar procesin edukativ të sensibilizimit të komunitetit;
- Të shkruarit të një historie për një temë për punën e fëmijëve, me teknika të caktuar, duke përmirësuar aftësitë letrare dhe komunikuese;
- Studimi, përgatitja dhe mbajtja e një debati publik për punën e fëmijëve;
- Përbajtja me mjetet e komunikimit, për të ngjallur vëmendjen e publikut për punën e fëmijëve, për të mësuar se si të shkruajnë një njoftim shtypi dhe për të siguruar botimin e tij, si dhe për të përgatitur dhe realizuar një intervistë radiofonike ose televizive;
- Nxitja dhe përfshirja e komunitetit në çështjen e punës së fëmijëve, duke përforduar rolin e të rinjve si nismëtarë të ndryshimeve sociale;
- Paraqitja e mekanizmave të tregut të punës, duke diskutuar rolet që kanë sektorë të ndryshëm të shoqërisë dhe mënyra se si ato veprojnë në të mirë të shoqërisë;
- Nxitja e interesimit dhe pjesëmarrjes së komunitetit për punën e fëmijëve;
- Shkathtësitë e të qenit trajner.

Grupi i synuar

Grupi i synuar i programit të trajnimit janë mësimdhënësit e fushave të ndryshme kurrikulare, e në veçanti të fushës 'Shoqëria dhe mjedisi', 'Jeta dhe puna', 'Gjuhët dhe komunikimi', 'Artet', etj. Në këtë

 KEC Qendra për Arsim e Kosovës Kosova Education Center	SYLLABUSI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT		F-042
	Prishtinë	v. 2.0	Faqe 4 nga 5

trajnim është e rekomandueshme të përfshihet edhe shërbimi profesional i shkollave (pedagogët, psikologët), koordinatorët e cilësisë, etj.

Ky program fillimisht është pilotuar me një grup prej 14 pjesëmarrësish të përzgjedhur sipas kriterëve të caktuara³, pastaj është finalizuar dhe përgatitur për aprovim nga KShLM. Kandidatët e suksesshëm të grupit të parë janë propozuar për certifikim, të cilëve do t'u ipen certifikatat pas aprovimit të programit. Të certifikuarit e këtij grupi do të shfrytëzohen për trajnimin e mësimdhënësve në shkolla, numri i të cilëve varet nga MASHTI, dhe donatorët potencialë.

Forma e organizimit të trajnimit dhe kohëzgjatja

Programi i trajnimit është program treditor i përbërë nga gjithsejt 12 sesione. Secili sesion zgjat 90 minuta. Në ditën e parë fillohet me sesionin orientues, pastaj programi me aktivitetet e moduleve shpaloset në pesë sesionet tjera me radhë, të shtrira në dy ditë. Dy sesionet e fundit të ditës së dytë i dedikohen planifikimit për zbatim të moduleve në shkollë dhe planit të mentorimit. Këto sesione kanë sesione plenare dhe punë gupore, varësisht nga natyra e modulit. Dita e tretë i kushtohet prezantimit të punës së bërë gjatë realizimit të moduleve, me ç'rast ipet informata kthye nga 'miqtë kritik', dhe zhvillohen diskutime. Forma e realizimit të ditës së tretë mund të ndryshojë varësisht nga numri i pjesëmarrësve, bëhen prezantime klasike me poërr point dhe pastaj diskutime, apo, organizohen poster prezantime ku miqtë kritik observojnë, marrin shënime, pyesin, etj., dhe në fund realizohet diskutim i hapur konstruktiv për mënyrën e realizimit, për sfidat që janë hasur dhe se si ka mundur të realizohej ndryshe. Për trajnimin e trajnerëve, njëri sesion i ditës tretë i kushtohet standardeve të fasilitimit me të rriturit, ndërsa kur targeti i trajnimit janë mësimdhënësit, ky sesion i kushtohet prezantimeve dhe diskutimeve të mësimdhënësve, sepse në ato raste numri i pjesëmarrësve është më i madh. Në këtë sesion, mësimdhënësit udhëzohen që përmbajtjet e pakos SCREAM t'i përfshijnë në planifikimin vjetor të punës së tyre me nxënës, si aktivitet kurrikular, ndërkurrikular, projekte mësimore apo lëndë zgjedhore të ndryshme.

Në mes të ditës së dytë dhe tretë janë disa javë që pjesëmarrësit të planifikojnë dhe realizojnë aktivitetet e programit me nxënës në shkollë. Pasi kanë përzgjedhur aktivitetin nga moduli i preferuar (në sesionin e fundit të ditës së dytë të trajnimit) kandidatët do të planifikojnë dhe realizojnë individualisht së paku nga një aktivitet me nxënës në shkollë, varësisht nga lënda që e mbajnë apo preferenca e tyre për aktivitete jashtë-kurrikulare. Nëse kanë interesim, ata mund të realizojnë edhe aktivitete ekipore, ku mund të integrohen çështje nga fusha të ndryshme mësimore të ndërlidhura me punën e fëmijëve. Gjatë tërë kësaj periudhe pjesëmarrësit do të mbledhin evidenca nga realizimi i aktiviteteve, planet dhe analizat e bëra për aktivitetet e realizuara, foto të aktiviteteve dhe produktet e dalura, të cilat do t'i artikulojnë dhe t'i dorëzojnë si dëshmi për tu certifikuar. Gjatë periudhës së realizimit të aktiviteteve, kandidatët do të mbështeten dhe mentorohen nga trajnerët e kursit. Evidencat

³ Kandidatët potencial për trajner të këtij programi janë përzgjedhur në bazë të kriterëve vijuese:

- Të jenë mësimdhënës entuziast dhe me performancë të lartë të shkollave të mesme të ulta dhe të larta;
- Të kenë trajnime të përfunduara nga fusha të ndryshme kurrikulare, dhe më gjerë;
- Përparësi kanë kandidatët që kanë të përfunduar kursin e standardeve të fasilitimit, respektivisht të shkathtësive për trajnim.

 KEC Qendra për Arsim e Kosovës Kosova Education Center	SYLLABUSI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT		F-042
	Prishtinë	v. 2.0	Faqe 5 nga 5

/ portfoliot për realizimin e aktiviteteve do të dorëzohen një javë para ditës së tretë, për vlerësim dhe plotësime eventuale. Pastaj ato përmbledhen për tu prezantuar në ditën e tretë të trajnimit, dhe diskutohen me pjesëmarrësit e tjerë.

Vlerësimi / Certifikimi

Për t'u certifikuar si trajnerë për programin SCREAM, në fund të punëtorisë tre ditore do të realizohet vlerësimi i kandidatëve. Trajnerët do të certifikohen duke u kredituar me gjithsej 32 orë pedagogjike.

Kalkulimi i pikëve për licencim:

$32 \text{ pikë}^4 = 8 \text{ orë pedagogjike (45')} \times 3 \text{ ditë trajnimi} + 8 \text{ orë pedagogjike për zbatim të aktiviteteve në shkollë.}$

Kriteret për certifikim janë:

- 90% pjesëmarrje aktive në trajnim dhe në takimet reflektuese me mentor;
- Realizimi i së paku një aktiviteti të përzgjedhur nga njëri modul i pakos SCREAM, dhe mbledhja e evidencës me nxënës gjatë punës me nxënës (krijimi i portfolios);
- Demonstrimi i shkathtësive moderuese gjatë prezantimit të portfolios/produktit final të realizuar me nxënës;
- Pjesëmarrje aktive me diskutime në sesionet finale gjatë prezantimit të pjesëmarrësve.

Vlerësimi dhe komentet për portfolio bëhen nga trajneri i kursit, para ditës tretë. Ndërsa në ditën e tretë ata prezantojnë për pjesëmarrësit e tjerë, marrin sugjerimet prej tyre dhe bëhet një diskutim i hapur për mundësitë tjera të realizimit të aktiviteteve në shkollë. Për vlerësim final të kandidatëve merret parasysh edhe aktiviteti i tyre gjatë këtyre diskutimeve, përfshirë shkathtësitë e prezantimit.

Materialet e trajnimit:

Dokumenti kryesor burimor për trajnimin është pakoja e moduleve SCREAM - Ndal punës së fëmijëve. Materiali përfshinë informata, burime, udhëzime dhe mjete për t'u përdorur gjatë trajnimit të temave të ndryshme të adresuara përmes 14 moduleve.

- *Udhëzuesi për fasilitues të programit trajnues së bashku me fletat e punës;*
- *Sllajdet në Poëer Point dhe Video prezantimet.*

Dokumentet tjera burimore përfshijnë:

- *Udhëzimin Administrativ QRK Nr. 05/2013 për Parandalimin dhe Ndalimin e Formave të Rrezikshme të Punës së Fëmijëve në Kosovë;*
- *Procedurat Standarde të Veprimit për fëmijët në format e rrezikshme të punës.*

⁴ Sipas UA 6/2017 për Kriteret dhe procedurat e aprovimit të programeve për zhvillim profesional të mësimeve, Neni 2, Pika 9, një ditë e plotë trajnimi përbëhet prej 6 orëve të plota. Ndërsa nga agjenda e trajnimit mund të shihet se një ditë përbëhet nga 4 sesione 90 minutëshe, apo 8 orë pedagogjike 45 minutëshe.